



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
QENDRA E PRITJES PËR AZIL

RAPORTI VJETOR QENDRA E PRITJES PËR AZIL

VITI 2024

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	
STATUSI JURIDIK I QPA-SË DHE STRUKTURA	- 1 -
• Struktura e QPA-së dhe organigrama.....	- 1 -
• Organigrama e Qendrës së Pritjes për Azil	- 1 -
REALIZIMET SIPAS PRIORITETEVE TË MINISTRISË SË BRENDSHME	- 2 -
SEKTORI I MBËSHTETJES SË AZILKËRKUESVE.....	- 3 -
• Bashkëpunimi me struktura të Policisë së Shtetit dhe Bashkisë Kamëz.....	- 6 -
• Njohja e azilkërkuesve me të drejtat dhe detyrimet e tyre si dhe procedurat e azilit	- 6 -
• Aktivitete të realizuara	- 6 -
SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	- 8 -
• Realizimi i zërave të buxhetit për vitin 2024.....	- 8 -
• Shpeznime nga buxheti i shtetit për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024 janë sipas pasqyrës së mëposhtme.....	- 8 -
BURIMET NJERËZORE	- 10 -
• Trajnimet.....	Error! Bookmark not defined.
• REALIZIMI I ZËRAVE TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR VITIN 2024 -	10 -
PROBLEMATIKAT E HASURA NË PUNËN E QPA-SË, GJATË VITIT 2024	- 12 -
ARRITJE	- 13 -
PRIORITETET DHE MASAT ME RËNDËSI NË AKTIVITETIN E QPA-SË PËR VITIN 2025	- 13 -

HYRJE

Raporti Vjetor 2024 i Qendrës së Pritjes për Azil është një dokument gjithëpërfshirës i punës dhe aktiviteteve institucionale si dhe rezultateve të arritura, duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi. Raporti paraqet zhvillimet kryesore në Qendrën e Pritjes për Azil, si dhe jep rekomandime për përmirësimin e performancës së institucionit. Disa prej çështjeve kryesore të trajtuara në raport janë: statusi ligjor dhe struktura e institucionit, realizimi i buxhetit për vitin 2023 dhe aktivitetet institucionale. Kjo përmbledhje, shfaq jo vetëm objektivat dhe rezultatet e arritura, por gjithashtu nxjerr në pah problematikat që janë evidentuar gjatë vitit raportues.

Qendra ka për mision respektimin e legjislacionit të brendshëm dhe atë ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me fokus ato të azilkërkuesve dhe refugjatëve si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të shërbimeve të ofruara për azilkërkuesit dhe refugjatët e akomoduar.

Gjashtë mujori i parë i vitit 2024 ka qenë tejet i rëndësishëm dhe sfidues për Qendrën pasi shënoi një numër të rritur azilkërkuesish të akomoduar, me shtetësi të ndryshme, kryesisht nga Afganistani, Siria dhe Pakistani. Prioriteti i punës sonë ka qenë dhe mbetet mbarëvajtja dhe organizimi i pritjes së tyre, akomodimi dhe ofrimi i shërbimeve të domosdoshme.

Ndër objektivat e Qendrës ka qenë edhe administrimi me efektivitet i fondeve buxhetore dhe burimeve financiare duke ndjekur zbatimin e planifikimit të fondeve buxhetore miratuar për vitin 2024 dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ndërveprimi me të gjitha strukturat që operojnë në fushën e migracionit dhe azilit.

QPA, jo vetëm gjatë vitit raportues, por edhe në vazhdim, angazhohet në zgjidhjen e sfidave të ardhshme, duke u udhëhequr nga përgjegjshmëria, integriteti dhe transparenca për të punuar me përkushtim e seriozitet drejt cilësisë së shërbimeve e përmbushjes së standardeve më të larta sa i takon shërbimeve të ofruara për azilkërkuesit/refugjatët.

STATUSI JURIDIK I QPA-SË DHE STRUKTURA

Qendra e Pritjes për Azil është institucion ku akomodohen dhe trajtohen persona të huaj me apo pa shtetësi që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në Shqipëri në respektim të legjislacionit të brendshëm dhe ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me fokus ato të azilkërkuesve dhe refugjatëve.

Funksionon në varësi të Ministrisë së Brendshme nga viti 2004, me VKM Nr. 262, datë 23.04.2004 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit, në Babrru, Tiranë, Ministrisë së Rendit Publik, si dhe për organizimin e funksionimit të saj dhe për shtesë në numrin e parashikuar të punonjësve të kësaj ministrie”.

Aktualisht Qendra e Pritjes për Azil funksionon sipas strukturës së miratuar më Urdhër të Kryeministrit Nr. 33, datë 13.02.2024


dhe VKM-së Nr. 630, datë 27.10.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Pritjes për Azil”.

- **Struktura e QPA-së dhe organigrama**

Qendra e Pritjes për Azil është e organizuar në dy sektorë me përbërje prej 15 punonjës:

- 1- Titullari i Institucionit.
- 2- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse me 11 punonjës.
- 3- Sektori i Mbështetjes së Azilkërkuesve me 3 punonjës.

- **Organigrama e Qendrës së Pritjes për Azil**



REALIZIMET SIPAS PRIORITETEVE TË MINISTRISË SË BRENDSHME

Gjatë vitit 2024, Qendra e Pritjes për Azil ka punuar me impenjimin dhe profesionalizmin e duhur për realizimin e detyrave dhe objektivave sipas përgjegjësiqe që përcaktohen në aktet ligjore dhe ato normative që rregullojnë funksionimin e institucionit.

Në kuadër të objektivave dhe detyrave të përcaktuara në dokumentin e prioriteteve të Ministrisë së Brendshme për vitin 2024, paraqitet në mënyrë të përmbledhur veprimtaria për këtë periudhë:

1. Është bërë analiza dhe programimi për rialokimin e fondeve sipas nevojave emergjente të institucionit dhe ndryshimet në zërat në Regjistrin e Planifikimit të procedurave të prokurimit për vitin 2024.
2. Është hartuar Projekt-buxheti Afatmesëm për vitet 2025-2027, ku është bashkëngjitur kërkesa shtesë:
 - Ndryshimin e strukturës së QPA-së nga 15 punonjës në 25 punonjës.
 - Panele Fotovoltaike (PFV) për Qendrën e Pritjes për Azil.
 - Blerje makinë elektrike për Qendrën e Pritjes për Azil.
3. Janë hartuar e miratuar programe pune, raporte mujore dhe raporte të tjera periodike, të cilat pasqyrojnë objektivat kryesore, punën e kryer në përmbushje të tyre, burimet dhe kapacitetet e angazhuara dhe tregues të tjerë për institucionin.
4. Është plotësuar e përditësuar dosja personale për çdo punonjës, me gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor e administrativ. Përditësohen periodikisht Regjistri i Punëmarrësit dhe ndiqet dinamika e pasurimit të dosjeve me vlerësime periodike, praktika disiplinore, vjetërsi në punë e procedura të tjera që shoqërojnë punonjësin gjatë veprimtarisë së punës.
5. Është ndërtuar një procedurë e rregullt administrative e ligjore, sa i përket emërimeve të punonjësve të rinj, praktikave disiplinore dhe atyre të lirimit nga detyra. Për çdo rast, plotësohet sipas standardeve dokumentacioni i duhur dhe ndiqen etapat përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Janë marrë masat e duhura për të rritur sigurinë dhe mbrojtjen në punë sipas standardeve ligjore. Pajisjet fikëse të zjarrit janë të mbushura dhe brenda afatit të skadencës, janë të kolauduara dhe janë në gatishmëri për çdo emergjencë të mundshme.

SEKTORI I MBËSHTETJES SË AZILKËRKUESVE

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024, Qendra e Pritjes për Azil ka pritur dhe akomoduar në total 97 azilkërkues sipas statistikave të mëposhtme:

- o 70 të rritur, ku nga këto 23 janë femra dhe 47 meshkuj; 27 të mitur, përkatësisht 8 vajza dhe 19 djem.


Muaji	0 -18vjeç		Mbi 18 vjeç (të rritur)		Totali
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	
Janar-Dhjetor 2024	8	19	23	47	97
Janar-Dhjetor 2023	48	83	58	67	256
Janar-Dhjetor 2022	13	17	26	28	84

- o 24 janë minorenë të shoqëruar dhe 3 janë minorenë të pashoqëruar.


Muaji	Minoren	
	Të shoqëruar	Të pashoqëruar
Janar-Dhjetor 2024	24	3
Janar-Dhjetor 2023	131	1
Janar-Dhjetor 2022	30	0

Për sa i përket numrit të minorenëve të pashoqëruar, të akomoduar raportohen 3 minorenë të pashoqëruar të akomoduar në Qendër gjatë vitit 2024.


Sipas një krahasimi të bërë, vihet re se gjatë tre viteve të fundit numri i azilkërkuesve të akomoduar ka pësuar një rritje. Konkretisht numri i azilkërkuesve të akomoduar në periudhën në periudhën Janar-Dhjetor 2022 është 84 persona. Numri i azilkërkuesve të akomoduar në periudhën Janar-Dhjetor 2023 është më i lartë në krahasim me periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2024, ku konkretisht në periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë akomoduar 256 persona dhe në periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë akomoduar 97 persona.



Grafiku tregon se gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024, në muajin Mars numri i azilkërkuesve të akomoduar është më i lartë në krahasim me muajt e tjerë.



Grafiku tregon se gjatë periudhës, Janar-Dhjetor 2024 familjet e akomoduara kanë qënë në total 15 familje, ku 37 % prej tyre me origjinë nga Afganistani, 19% e tyre me origjinë nga Siri, 13% e tyre me origjinë nga Ukraina, 6 % e tyre me origjinë nga Armenia, 13% e tyre me origjinë nga Iraku, 6% me origjinë nga Irani dhe 6% me origjinë nga Kazakistani.



Dymbëdhjetë prej azilkërkuesve të akomoduar me origjinë nga Siria, me kërkesën e tyre janë zhvendosur jashtë Qendrës me mbështetjen e UNHCR-së dhe RMSA-së për ndjekjen e procedurave përkatëse për azil. Gjithashtu katër prej azilkërkuesve të akomoduar me origjinë nga Ukraina, tre prej azilkërkuesve të akomoduar me origjinë nga Siria, një prej azilkërkuesve të akomoduar me origjinë nga Kameruni dhe një prej azilkërkuesve të akomoduar me origjinë nga Nigeria me kërkesën e tyre janë zhvendosur jashtë Qendrës me të ardhurat e tyre për ndjekjen e procedurave përkatëse për azil. Tabela e mëposhtme paraqet një pamje më të qartë.

NR.	SHTETËSIA	PERSONA	MESHKUJ	FEMRA
1	Siri	15	7	8
2	Ukrainë	4	2	2
3	Nigeri	1	0	1
4	Kamerun	1	0	1
TOTALI		21	9	12

- **Bashkëpunimi me struktura të Policisë së Shtetit dhe Bashkisë Kamëz.**

- Bashkëpunimi me strukturat e Policisë ka qënë i vazhdueshëm dhe shumë efikas, i cili ka qënë i domosdoshëm për koordinimin e informacionit midis strukturave përkatëse.
- Bashkëpunimi me Drejtorinë e Azilit dhe Shtetësisë në Ministri, për problemet e statusit të azilkërkuesve.
- Ndër organizatat me të cilat bashkëpunon Qendra janë; UNHCR, RMSA, Qendra Tek Ura etj. UNHCR dhe RMSA kanë mundësuar shërbimin mjekësor me një infermiere. Konkretisht gjatë kësaj periudhe këtë shërbim e kanë përfituar shumë azilkërkues. Infermierja ka ofruar shërbimin e parë dhe ka asistuar në shoqërimin e tyre në qendra të ndryshme shëndetësore dhe spitalore. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024 janë ofruar 779 shërbime shëndetësore.
- Për të krijuar një mjedis sa më argëtues dhe relaksues për fëmijët në Qendër ndodhet një dhomë posaçërisht për ta, e quajtur “Dhoma e fëmijëve”. Punojësit e Sektorit të Mbështetjes së Azilkërkuesve bëjnë të mundur shoqërimin e fëmijëve duke krijuar lojëra argëtuese dhe zhvilluese për ta. Përpos dhomës së fëmijëve Qendra ofron gjithashtu edhe sallën e internetit dhe bibliotekën, ku azilkërkuesit mund të aksesojnë në internet dhe të komunikojnë me familjarët e tyre. Psikologjia e Qendrës ka bërë vlerësime psikologjike me azilkërkuesit.

- **Njohja e azilkërkuesve me të drejtat dhe detyrimet e tyre si dhe procedurat e azilit**

Në momentin e akomodimit kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare njihen me rregullat e brendshme të kësaj Qendre si dhe të drejtat dhe detyrimet që ata kanë. Më pas u lind e drejta për të marrë informacion mbi vazhdimësinë e procedurave për azil, njëkohësisht u shpërndahet një fletëpalosje ku pasqyrohen të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe fletëpalosje që informojnë kërkuesin për mbrojtje ndërkombëtare në lidhje me fenomene të ndryshme si Trafikimi dhe Kondrabandimi në gjuhën angleze dhe arabe.

- **Aktivitete të realizuara**

Gjatë vitit 2024 organizata të ndryshme kanë bashkëpunuar me Qendrën në ditë festash por jo vetëm për t’iu sjellë azilkërkuesve dhe refugjatëve një ditë ndryshe.

- Në kuadër të ditës ndërkombëtare të gruas “8 Mars”, në bashkëpunim me RMSA u organizuan disa aktivitete dhe lojëra të ndryshme për fëmijë dhe të rritur.

- Në muajin Prill, duke simbolizuar ardhjen e pranverës, së bashku me shtetasit e akomoduar në Qendër mbollëm lule në ambjentin e jashtëm të Qendrës.
- Më 22.04.2024 në ditën Ndërkombëtare të Tokës së bashku me fëmijët mësuam më shumë rreth një mjedisi të pastër dhe kujdesit ndaj tij.
- Më datë 8 Maj, në bashkëpunim me RMSA u organizua një aktivitet për prindërimin dhe si duhet të ndërtojmë një marrëdhënie të mirë mes fëmijës dhe prindit.
- Më 15 Maj në ditën ndërkombëtare të familjes, të gjithë së bashku u njohëm me rolin e familjes si themeli i shoqërisë njerëzore, një vend ku dashuria, mbështetja dhe solidariteti janë vlera që forcojnë lidhjet njerëzore pa dallim race, feje apo besimi fetar.
- Me rastin e festës së 1 Qershorit, në bashkëpunim me RMSA ngritëm balona, festuam, kënduam bashkë me fëmijët.
- Në përkujtimin e Ditës Ndërkombëtare të Refugjatëve – ditë në të cilën nderohen njerëzit të cilët janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre për ti shpëtuar konfliktit ose persekutimit u organizua një aktivitet në galerinë KALO Tiranë, ku u mbajt një ekspozitë fotografike e cila përkujtonte kontributet e figurave të njohura historike dhe bashkëkohore të zhvendosura me forcë dhe performancë muzikore dhe poetike nga fëmijë refugjatë që jetojnë në Shqipëri.
- Më datë 30 Korrik në kuadër të ditës Botërore kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore organizuam një sesion informues me shtetasit e akomoduar për të njohur më shumë këtë fenomen, mënyrat si të mbrohem dhe kujt ti kërkojmë ndihmë.
- Gjatë verës kemi bërë të mundur më së shumti marjen e njohurive në lidhje me kompjuterin shfrytëzimin i bibliotekës duke informuar përmes librin dhe mundësia për të qënë më pranë tij.
- Aktivitete të ndryshme si handcrafting, krijime handmade, vizatime, piktura etj.
- Më 5 Shtator u njohëm me figurën e shënjtorese së madhe Nënë Tereza që jetën e saj ia kushtoi bamirësisë dhe humanizmit.
- Në fillim të vitit shkollor, së bashku me fëmijët dhe prindërit, u njohëm me fenomenin e Bullizmit, format dhe ndërgjegjësimin e nevojshëm në lidhje me të.
- Në 30 Tetor u organizua një sesion informues nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në lidhje me ndërgjegjësimin dhe informimin ndaj këtij fenomeni me azilkërkuesit e akomoduar në Qendër por dhe jashtë saj.

- Në kuadër të ditëve kundër viktimizimit të gruas, u mbajt një aktivitet në bashkëpunim me RMSA në Muzeun e Gruas, ku sëbashku me gratë dhe fëmijët bëmë të mundur vizitën dhe marjen e informacionit të rëndësishëm në këto ditë të shënuara për luftën kundër këtij fenomeni.
- Në Dhjetor organizuam një aktivitet të quajtur “Kartolina e Fundvitit” ku me shumë dashuri sëbashku me shtetasit krijuam kartolina për njerëzit tanë të zemrës me urimet më të mira për një vit të mbarë.


SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Hartimi, planifikimi, menaxhimi eficient dhe efektiv i buxhetit për plotësimin e nevojave të azilkërkuesve/refugjatëve merr një rëndësi të veçantë për institucionin tonë. Përsa i përket zbatimit të buxhetit, fondi i akorduar në fillim të vitit 2024, në nivel artikulli për njësinë shpenzuese QPA është në total 42.869.000 lekë, me një diferencë prej 20.156.000 lekë në krahasim me fillimin e vitit 2023. Kjo vlerë është e detajuar sipas zërave të shpenzimeve të strukturës buxhetore e paraqitur dhe në tabelën e realizimit të mëposhtëm.

• Realizimi i zërave të buxhetit për vitin 2024

Shpenzime nga buxheti i shtetit për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024 janë sipas pasqyrës së mëposhtme:

Nr.	Art	Emërtimi	Plani vjetor 2024	Plani me ndryshi me	Realizimi vjetor 2024	Diferenca	Realizimi ne %
1	600	Paga,shpërblime dhe te tjera shpenzime personeli	14.299	+820	14.785	334	98
2	601	Kontribute për sigurime shoqerore e shëndetësore	2.388	+137	2.480	45	98
3	602	Mallra e shërbime	19.555		18.049	1.506	92
4	606	Transferta për buxhete familjare individ	5.620	+50	4.150	1.520	73
		T O T A L I	41.862	1007	39.464	3.405	92



Bazuar në VKM Nr. 581, datë 10.08.2011 “Për dhënie ndihme financiare një kategorie personash të strehuar në Republikën e Shqipërisë” dhe të Udhëzimit Nr. 33, datë 24.02.2012 “Për dhënien ndihmë financiare një kategorie personash të strehuar në Republikën e Shqipërisë”, në buxhetin e QPA-së është parashikuar në shumën prej 5.620.000 lekë për të mbuluar dhënien e ndihmës financiare për gjashtë familje për pagesën e qerasë së banesës, të ushqimit, energjisë elektrike dhe të ujit është realizuar në masën 73%.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024 janë bërë ndryshime (shtesa) fondesh në krahasim me akordimin fillestar të buxhetit. Këto ndryshime janë bërë në artikullin 606 “Fond i veçantë në shumën 50.000 lekë, artikulli 600 në shumën 820.000 lekë, në artikullin 601 në shumën 137.000 lekë.

Shtesat e fondeve janë bërë me kërkesë të QPA-së dhe të miratuara nga Ministria e Brendshme. Është bërë rakordimi i fondeve dhe me ndryshimet që kanë pësuar zërat gjatë periudhës Janar -Dhjetor 2024 me degën e thesarit, duke pasqyruar transaksionet e kryera deri në nivel nënartikulli sipas strukturës dhe klasifikimit buxhetor.

Ndjekja, realizimi dhe raportimi i buxhetit është bërë nëpërmjet evidencave progresive të realizimit të buxhetit, janë përgatitur pasqyra 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore e raportimit të buxhetit

sipas zërave dhe nënzërave e cila është rakorduar dhe vulosur nga dega e thesarit dhe është dërguar në Ministri. Gjithashtu për realizimin e buxhetit çdo muaj raportohet në Ministri.

QPA-ja ka ndjekur në vazhdimsi respektimin e strukturës së miratuar me VKM- nr. 630, datë 27.10.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkues”, përsa i përket numrit të punonjësve në QPA. Kërkohet ndryshimi i strukturës pasi struktura aktuale nuk i plotëson të gjitha kërkesat për një shërbim sa më efikas të azilkërkuesve, ku parashikohet të ndryshojë dhe me 10 punonjës shtesë për të cilën nevojitet fond page 10.542 lekë dhe sigurime shoqërore 1.760 lekë.

BURIMET NJERËZORE

QPA-ja ka ndjekur në vazhdimësi respektimin e strukturës së miratuar me VKM-në nr. 630, datë 27.10.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Pritjes për Azil”, përsa i përket numrit të punonjësve. Është proceduar për plotësimin e vendit vakant Kuzhinjere si dhe në mbështetje të vendimit Nr.39 datë 24.01.2024 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2024, në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore” është proceduar për marjen në punë të tre punonjësve me kontratë: Mirëmbajtës, Kujdestar Nate dhe Specialist Finance. Është mbajtur dhe përditësuar Regjistri Qëndror i Personelit nga Specialisti i Burimeve Njerëzore.

Për sa i përket trajnimeve në kuadër të ngritjes të aftësive profesionale, menaxhuese dhe funksionale të punonjësve në funksion të procesit të standardizimit të kujdesit dhe shërbimeve të ofruara, është mundësuar pjesëmarrja e punonjësve në disa trajnime të organizuara nga organizata të ndryshme.

Gjatë Periudhës Janar-Dhjetor 2024 janë realizuar këto trajnime online dhe me precencë fizike:

- “Llojet e kontratave të punës, përfundimi i marrëdhënieve të punës dhe zgjidhja e menjëhershme e kontratës” Datë: 29 Prill 2024, ASPA (Online)
- “Lëvizja e lirë e personave” Datë: 30 Prill 2024, ASPA (Online)
- “Mbrojta mbështetja dhe siguria e të rinjve” Datë: 23 Maj 2024, ASPA (Online)
- “Higjiena kibernetike dhe praktikat më të mira të sigurisë” Datë: 28 Maj 2024 AKSK (Online)
- “Prokurimi me vlerë të vogël” Datë 10 Qershor 2024, AKPA (Online)
- “Let’s speak asylum” Workshop Online EUAA, Mars 2024

- “Reception of vulnerable persons: identification of vulnerability and provision of initial support targeted for Reception officers” EUAA (Online/Face to face)
- “Professional well-being (PW) targeted for both Asylum and Reception Officers” EUAA (Online)
- “Children in the asylum process targed for both Asylum and Reception Officers” EUAA (Online/Face to face)
- “Victims of gender-based violence targeted for both Asylum and Reception Officers” EUAA (Online/Face to face)
- “Mbrotjtja e Fëmijëve Online”, 27 Shtator 2024, ASPA (Online)
- “Introduction to vulnerability”, Tetor-Nëntor 2024, EUAA (Online)
- “Parime, praktika dhe risi në menaxhimin e burimeve njerëzore” 15 Tetor 2024, ASPA,(Online)
- “Trajnim për Prokurim Publik” 24 Tetor- 26 Nëntor 2024, Online/Face to face, ISSAT
- “Introduction to Reception”, Nëntor-Dhjetor 2024, EUAA (Online)
- “Integrimi i të huajve në ballkanin perëndimor”19-21 Nëntor 2024 Durrës, FOSTER, Komuniteti Shqiptar i Helsinkit.
- Workshop Rajonal Budva Montenegro “Menaxhimi i Vulnerabilitetit në zonat e pritjes” 4-5 Dhjetor 2024.
- “Identifikimi i grupeve të interesit për pjesë të caktuara të procesit të negociatave” ASPA, 16-18 dhjetor 2024, (Online)

REALIZIMI I ZËRAVE TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR VITIN 2024

Nr.	Objekti i Prokurimit	Vlera e kontratës	Organi i financimit
1.	Blerje materiale ndriçimi dhe hidrike	97,300	Buxheti i Shtetit
2.	Larje Makine	100,000	Buxheti i Shtetit
3.	Sherbimi i softit informatik	100,000	Buxheti i Shtetit
4.	Shpenzime të siguracioneve të mjeteve te transportit	70,000	Buxheti i Shtetit
5.	Shërbim i mirëmbajtjes së aparateve të paisjeve të ambienteve të Qendrës	989,200	Buxheti i Shtetit
6.	Materiale pastrimi, detergjente	419,000	Buxheti i Shtetit

7.	Blerje artikuj ushqimore	1,774,822	Buxheti i Shtetit
8.	Blerje ilaçe mjekësore	81,118	Buxheti i Shtetit
9.	Uniforma dhe veshje	400,000	Buxheti i Shtetit
10.	Dizinfektim	97,566	Buxheti i Shtetit
11.	Blerje tonera per printera	97,000	Buxheti i Shtetit
12.	Shpenzime per mirembajtjen e pajisjeve te zyrave	95,000	Buxheti i Shtetit
13.	Shpenzime për mirmbajtje automjeti	94,050	Buxheti i Shtetit
14.	Nevoje për riparim automjeti	95,000	Buxheti i Shtetit
15.	Nevoje per zevendesim xhami te perparme automjeti	25,417	Buxheti i Shtetit
16.	Kancelari	99,595	Buxheti i Shtetit
17.	Te tjera materiale (Tabela informuese)	91,300	Buxheti i Shtetit
18.	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	99,500	Buxheti i Shtetit
19.	Sherbim aktivitet per azilkerkuesit	96,240	Buxheti i Shtetit
20.	Kostot e trajnimit e te seminarit	40,000	Buxheti i Shtetit
21.	Shërbime të pastrimit dhe gjelberimit	97,050	Buxheti i Shtetit
22.	Shpenzime per kanalizimet e ujrave te zeza	98,000	Buxheti i Shtetit
23.	Elektricitet	1,295,454	Buxheti i Shtetit
24.	Uje	909,616	Buxheti i Shtetit
25.	Posta	3,017	Buxheti i Shtetit
26.	Sherbimi I sigurimit dhe ruajtjes fizike	6,783,936	Buxheti i Shtetit
27.	Karburant dhe vaj	299,923	Buxheti i Shtetit
28.	Taksat e bashkisë	36,350	Buxheti i Shtetit
29.	Internet	60,000	Buxheti i Shtetit

PROBLEMATIKAT E HASURA NË PUNËN E QPA-SË, GJATË VITIT 2024

- Mungesa e specialistëve të fushës brenda QPA-së për hartimin e standardeve, përshkrimin e specifikimeve teknike të disa objekteve të prokurimit (mallra/shërbime), ka sjellë si domosdoshmëri bashkëpunimin me Ministrinë e Brendshme ose me institucione të varësisë.
- Duke qenë se ofrohet shërbim 24/7 edhe gjatë fundjavës përfshirë edhe ditët e festave zyrtare dhe referuar numrit të pamjaftueshëm të punonjësve në strukturën e QPA-së, hasim vështirësi në përfitimin e ditëve të pushimit sipas Kodit të Punës nga ana e specialistëve të sektorit të mbështetjes së azilkerkuesve.
- Mungesa e mjekut dhe infermierit në strukturën e QPA-së, për t'u asistuar në qendër dhe për të dhënë ndihmën e parë azilkerkuesve/refugjatëve, duke i shoqëruar dhe transportuar në çdo kohë pranë qendrave shëndetësore dhe spitalore, përkthyer në kosto në transport, në kohë dhe në punonjës, pasi në shoqërimin e të sëmurit në urgjencë, në spital apo në qendrën shëndetësore në

lagje, punonjësit i duhet të shkëputet nga problemet e shumta të cilat ndërkohë duhet t'i ndjekë në Qendër.

- Mirëmbajtësi, pjesë e strukturës së QPA, është i domosdoshëm për kryerjen e riparimeve dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe materialeve të ndryshme në ambientet e akomodimit dhe ambientet e tjera ndihmëse.

ARRITJE

- Realizimi i objektivave me efektivitet në kuadër të ofrimit të shërbimeve sipas standardeve të duhura për kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare që akomodohen në Qendër, ka udhëhequr punën e përditshme të stafit ku është reflektuar në mungesa të problematikave të evidentuara përgjatë vitit që çënojnë integritetin, funksionimin dhe imazhin e përgjithshëm të institucionit.
- Realizimi i trajnimeve dhe kualifikimeve të stafit në tërësi por edhe atyre që kanë marrëdhënie të drejtpërdrejtë me azilkërkuesit/refugjatët, grupet vulnerabël, e cila çon në rritjen e standardeve lidhur me cilësinë e ofrimit të shërbimeve brenda Qendrës.

PRIORITETET DHE MASAT ME RËNDËSI NË AKTIVITETIN E QPA-SË PËR VITIN 2025

1. Të miratohen ndryshimet e kuotave financiare për shpenzime ditore për kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare të akomoduar në Qendër në mënyrë që të arrihet përmirësimi i standardeve të shërbimeve të ofruara.
2. Të miratohet një strukturë e re e Qendrës së Pritjes për Azil me staf multidisciplinar në mënyrë që të mbulohen të gjitha shërbimet dhe të rritet standarti i ofrimit të tyre.
3. Të bëhet i mundur organizimi i takimeve me partnerët mbi diskutime lidhur me tematikat e kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare si dhe forcimin e bashkëpunimit midis tyre.
4. Të mundësohet realizimi i trajnimeve dhe kualifikimeve të mëtijshme të stafit që kanë marrëdhënie të drejtpërdrejtë me azilkërkuesit/refugjatët, e cila çon në rritjen e standardeve lidhur me cilësinë e ofrimit të shërbimeve brenda Qendrës.

FALEMINDERIT!

DREJTORI
Ermir ALIÇKA